RELACION SHPJEGUES

"Për miratimin e heqje nga fondi të një sipërfaqeje pyjore–kullosore prej 2 Ha në territorin e Bashkisë Has për shoqërinë **"2R Group" sh.p.k.**

Qëllimi

Ky projekt–vendim ka për qëllim **heqje nga fondi** të një sipërfaqeje pyjore–kullosore prej 2 Ha në territorin e Bashkisë Has për shoqërinë **"2R Group" sh.p.k.**, me kerkese te Ministrise se Mjedisit.

Baza ligjore

- **Ligji nr. 139/2015**, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 16 dhe neni 17 pika "c", që përcaktojnë kompetencën e Këshillit Bashkiak për dhënien në përdorim të pasurive të bashkisë për qëllime ekonomike .
- **Ligji nr. 57/2020**, "Për Pyjet"
- **VKM** nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhëniës në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre"
- **VKM nr. 559, datë 29.07.2022**, "Për caktimin e tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar për veprimtari ekonomike, etj.";
- **Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016**, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
- **Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Has**

- Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria " 2R Group " shpk, e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, në n/ngastrat 30/a , ekonomia pyjore "Tregtan", ku hiqet një sipërfaqe prej 0.4 ha, dhe në nagstren nr.34 , hiqen 1.6 ha. Sipërfaqja që jepet në përdorim është 113 ml rruge në ngastren 34 dhe 287 ml rruge në ngastren nr.35 ekonomia pyjore "Tregtan". Sipërfaqja totale që hiqet nga fondi pyjor publik është **2 ha**, dhe sipërfaqja totale që jepet në përdorim, është rruga lidhese nga objekti me rrugën kryesore **400 ml**.

Arsyetimi :

Bazuar ne kerkesen qa na eshte bere nga Ministria e Mjedisit si dhe ne baze te VKM nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhëniës në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", siperfaqja prej 2 Ha qe hiqet, subjekti detyrohet te permbushe detyrimet me pyllezim kompensues sipas vendimit qe nxjerr Ministria e

Mjedisit, pas daljes se vendimit per heqje, subjekti ka per detyre permbushjen e detyrimeve qe lindin nga ky vendim, vetem pas permbushjes se ketyre detyrimeve subjekti ka te drejten te lidhe kontrate me bashkine Has.

Drejtoria e Sherbimit Pyjor:

Fadil DAUTI

